

LIGJ
Nr. 52/2017

**PËR RATIFIKIMIN E NDRYSHIMIT NR. 1 TË MARRËVESHJES SË GRANTIT
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI ADMINISTRATORE E FONDEVE
GRANT, TË SIGURUARA NGA AGJENCIA SUEDEZE PËR ZHVILLIMIN E
BASHKËPUNIMIT NDËRKOMBËTAR (SIDA) NËN FONDIN SUEDEZ TË BESIMIT,
PËR FONDIN E BESIMIT NR. TF072239, PËR PROJEKTIN E SHËRBIMEVE MJEDISORE
NË SHQIPËRI, TË RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.64/2015**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet ndryshimi nr. 1 i marrëveshjes së grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant, të siguruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin e Bashkëpunimit Ndërkombëtar (SIDA), nën Fondin Suedeze të Besimit, për Fondin e Besimit nr. TF072239, për projektin e shërbimeve mjedisore në Shqipëri, të ratifikuar me ligjin nr. 64/2015, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 13.4.2017

Shpallur me dekreten nr. 10222, datë 27.4.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

BANKA BOTËRORE

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim

1818H Street N.W
Washington, D.C. 20433 U.S.A

(202) 473-1000
Adresa kablllore : INTBAFRAD
Adresa kablllore: INDEVAS

25 mars 2016

Shkëlqesisë së Tij, Arben Ahmetaj
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi Dëshmorët e Kombit
Tiranë, Shqipëri

Lënda :Projekti i Shërbimeve Mjedisore në Shqipëri
TF (Fondi i Besimit) Suedeze nr. TF018238
Amendamenti nr.1 i Marrëveshjes së Grantit

Shkëlqesi:

I referohemi Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Marrësi") dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka Botërore"), e cila vepron si administratore e fondeve të grantit të ofruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA) për

projektin e lartpër-mendur të datës 10 tetor 2014 (“Marrëveshja”).

Në përputhje me diskutimin e kohëve të fundit ndërmjet Bankës Botërore dhe Marrësit në lidhje me uljen e shumës së Grantit me gjashtëqind e pesëdhjetë mijë Dollarë Amerikanë (\$ 650,000) për të reflektuar zhvlerësimin e SEK (monedha e kontributit të SIDA-s) ndaj Dollarit të Shteteve të Bashkuara (monedha që mban Grantin), Banka Botërore ka rënë dakort që të amendojë Marrëveshjen (Amendamenti) me formulimin e mëposhtëm:

1. Nëpërmjet këtij dokumenti, paragrafi 1 i Marrëveshjes amendohet për të reduktuar shumën e Grantit me formulimin e mëposhtëm:

“Në përgjigje të kërkesës për asistencë financiare të bërë në emër të Shqipërisë (“Marrësi”), kam kënaqësinë t’iu informoj se Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (“Banka Botërore”) që vepron si administratore e fondeve të grantit të ofruara nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, SIDA (“Donatori”) sipas Fondit të Besimit Suedeze për Projektin e Shërbimeve Mjedisore në Shqipëri me Fondin e Besimit nr. TF072239 (Kontributi i SIDA-s nr. 53030017) propozon që t’i japë Marrësit një grant në një shumë e cila nuk tejkalon shtatë milion e treqind e dhjetë mijë Dollarë të Shteteve të Bashkuara (\$7.310,000) (“Granti”) mbi kushtet dhe termat e përcaktuara ose të përmendura në këtë letër marrëveshjeje (“Marrëveshje”), e cila përfshin Shtojcën bashkëlidhur për të asistuar në financimin e projektit të përshkruar në Shtojcë (“Projekti”).”

2. Nëpërmjet këtij dokumenti, tabela në paragrafin 3.0 të Aneksit të Marrëveshjes ndryshohet me formulimin e mëposhtëm:

Shkëlqesia e tij, Arben Ahmetaj 25 mars 2016

Kategoria	Shuma e Grantit të Alokuar (e shprehur në USD)	Përqindja e Shpenzimeve që do të financohen (duke përfshirë taksat)
(1) Mallra, Punime, Shërbime Konsulence dhe Jo-konsulence. Trajnime, Kosto operative sipas Pjesës 1, Pjesës 2 (a) dhe (c), Pjesës 3 (a) dhe (c) dhe Pjesës 4 të Projektit.	5,640,000	100%
(2) Nënprojekte sipas Pjesës 2(b) të Projektit	1,670,000	100%
SHUMA TOTALE	7,310,000	

Të gjitha termat dhe kushtet e Marrëveshjes, me përjashtim të amendimeve në këtë dokument, mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutem konfirmoni marrëveshjen e Marrësit me letrën e mësipërme të Amendamentit, duke nënshkruar, vendosur datën dhe duke na kthyer kopjen bashkëlidhur të kësaj letre Amendamenti. Letra e Amendamentit do të hyjë në fuqi në datën kur Banka Botërore i dërgon Marrësit njoftim për marrjen e njoftimit të Marrësit, që ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj letre Amendamenti është autorizuar në mënyrën e duhur ose ratifikuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Me respekt

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM

Nga _____

Tahsenn Sayed

Menaxher Vendi/Shteti

Zyra e Bankës Botërore, Shqipëri

Rënë dakord:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____

